



**KALLËZIM PENAL**

**KALLËZUES:** Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Z. Çlirim Gjata, Sekretar për Çështjet Ligjore.

**OBJEKTI:** Kallëzim i veprës penale të “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, “ Shkelja e barazisë së pjesmarrësve në tendera apo ankande publike” parashikuar nga neni 258 i Kodit Penal, dhe “Përdorimi i funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore” parashikuar nga neni 328/a, i Kodit Penal.

**KUNDËR:**

[REDACTED]

Cdo person i pa identifikuar deri me tani nga ana jone por qe me veprime konkrete rezulton mbas hetimit qe ka perqejjesi penale.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 75/a, 280, 283 e vijues të K.Pr.Penale, neni 248, 258, 328/a i Kodit Penal, Neni 91 i Kodit Zgjedhor, Vendimi Nr 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nenet 8, 9, 10 e vijues të Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”,

**DREJTUAR:** PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT - SPAK.

*I nderuar Z. Drejtues i Prokurorisë,*

Bazuar në nenet 280 dhe 283 të K.Pr.Penale, po ju parashtrajmë këtë kallëzim penal për veprën penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, dispozitat ligjore penale të cënuara, si dhe analizën juridike dhe provat me anë të të cilave vërtetohet konsumimi i veprës penale.

**RRETHANAT E FAKTIT:**

Siç jeni në dijeni në 25 Prill do të zhvillohen zgjedhjet parlamentare dhe prej disa kohësh ka filluar organizimi partiak i subjekteve zgjedhore pavarësisht se ende zyrtarisht fushata zgjedhore nuk ka filluar.

Shtetasi [REDACTED] në cilësinë e [REDACTED] dhe në kundërshtim me Vendimin Nr 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nëpërmjet VKM nr. 1185, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e metodologjisë dhe të procedurave të monitorimit të qarkullimit në fushën e hidrokarbureve”, publikuar në Fletoren Zyrtare Nr. 27, datë 19.02.2021, akte provuese